

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Tonka Berishaj dhe Mejreme Memaj, anëtare të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Bujar Bala, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.K., nga Peja, për shkak të veprave penale –lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par. 1 nën par. 5 të KPK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar V.D., av. A.K., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë P.nr. 244/2010 të datës 26.05.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, me datën 22.09. 2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar V.D., av. A.K., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë P.nr. 244/2010 të datës 26.05.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë me aktgjykimin P nr. 244/2010 të datës 26.05.2017, të akuzuarin F.K., e ka shpallur fajtor për shkak të veprave penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par. 1 nën par. 5 të KPK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK, dhe i ka përcaktuar dënimet: për veprën penale në pikën I të dispozitivit dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti dhe për veprën penale në pikën II të dispozitivit dënim me gjobë në shumë prej 1000 € dhe konform dispozitës së nenit 71 të KPK i shqipton dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej një (1) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej një viti nuk kryen vepër të re penale. Në dënimin e

shqiptuar me burgim i njihet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej dt. 06.02.2010 deri me 06.03.2010 dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 €

Dënimin me gjobë duhet të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, e nëse i akuzuari refuzon ta paguan ose nëse nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë atëherë i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim duke u llogaritur një ditë burgim për çdo 15 € të gjobës së shqiptuar.

Të akuzuarit i është shqiptuar edhe dënim plotësues-konfiskimi i armës që ka qenë objekt në kryerjen e veprës penale-një revole e tipit CZ prodhim YU, me nr. serik 110524 dhe 8 fishek të kalibrit 9x19, të cilat pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit duhet asgjësuar.

I akuzuari është obliguar që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 300 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 25 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

-I dëmtuari V.D., përmes përfaqësuesit të autorizuar av. A.K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit për dënim, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovtojë si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë duke e zëvendësuar dënimin me kusht dhe të akuzuarit ti shqiptojë dënim me burg efektiv dhe dënim maksimal me gjobë.

Prokurori i Shtetit, me parashtresën PPA/I.nr 391/17 të dt. 25.08.2017, ka propozuar që të aprovohet pjesërisht ankesa e palës së dëmtuar ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet vetëm përkitazi me vendimin për dënimin për veprën penale nga neni 154 par. 1 pika 5 të KPK dhe për këtë vepër penale të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burg efektiv, ndërsa për shkaqet tjera- shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale ankesa të hudhet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e caktoi konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, në cilën palët nuk ishin të pranishme edhe pse të njoftuara me rregull dhe mungesën nuk e arsyetuan, prandaj seanca e kolegjit u mbajtiti në mungesë të tyre konform nenit 390 par. 4 të KPPK-së.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar edhe sipas detyrës zyrtare konformë dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

I dëmtuari V.D. përmes përfaqësuesit të tij av. A.K., aktgjykimin e kundërshtuar e ankimon për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, në kundërshtim me nenin 381

par. 3 të KPPK (neni 399 par. 3 KPPK-së - Kodi në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale), që parashikon se i dëmtuari mund të paraqes ankesë ndaj aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionin penal për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurimit të trafikut publik dhe shpenzimet e procedurës penale, ashtu që në këtë pjesë ankesa nuk është e lejuar.

Mirëpo, edhe pse ankesa përkitazi me bazën ankimore-shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk është e lejuar, Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi në pajtim me dispozitën e nenit 394 par. 1 të KPPK-së, sipas detyrës zyrtare dhe gjeti se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që kishin me kushtëzuar prishjen e tij. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, dispozitivi si dhe aktgjykimi i ankimuar në tërësi është i qartë dhe konkret, përmban arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje juridiko-penale. Kështu, përshkrimi i dhënë në dispozitiv është i plotë dhe i kuptueshëm, me asgjë të njëjtin nuk e bënë dubioz. Është bërë përshkrimi i duhur i veprimeve inkriminuese të akuzuarit, janë dhënë tiparet dhe faktet vendimtare të veprës penale për të akuzuarën. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsyet e duhura faktike dhe juridike të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Gjendja faktike nuk ka qenë objekt i vlerësimit i kësaj Gjykate, ngase në këtë drejtim nuk ka pasur ankesë e as që lejohet ankesa pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë - neni 383 par. 2 të KPPK-së, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë. Në ankesë theksohet se gjykata e shkallës së parë të akuzuarit për veprat penale për të cilën është shpallur fajtor i ka shqiptuar dënim me gjobë dhe me burgim me kusht i cili nuk është në proporcion me peshën e kësaj veprë, sjelljen dhe rrethanat e kryerësit dhe qëllimin e dënimit nga neni 41 të KPRK. Pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar rrethanat si moshën e të akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale 27 vjeç ndërsa i dëmtuari po sa kishte kalur moshën e të miturit (ishte 19 vjeç), pastaj faktin se i akuzuari e ka përdorur armën dhe duke e frikësuar të dëmtuarin pa asnjë pengesë e ka goditur duke i shkaktuar pasoja të cilat edhe sot i vuan.

Gjykata e Apelit gjënë se pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara sepse rrethanat të theksuara nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar paraqesin elementet e veprës penale për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor dhe gjykuar.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese që ishin në anën e tij, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti dhe më pas i ka shqiptuar dënimin në përputhje me këto rrethana. Kështu, ajo gjykatë si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar faktin se ai asnjëherë më parë nuk ka qenë i gjykuar, moshën relativisht të re në kohën e kryerjes së veprës penale, tani është në marrëdhënie pune dhe ka krijuar familje, është mbajtës i

familjes, sjelljet e të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe kërkim faljeje palës së dëmtuar, pranimin e fajit dhe pendimin e thellë për veprën e kryer. Vlerësimin e tillë të rrethanave për matjen e dënimit si të drejtë e pranon edhe Gjykata e Apelit, e cila gjen se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit, është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, si kryerës dhe se me këtë dënim do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPK-së. Në rrethana të këtilla nuk ekziston as asnjë arsye që atij ti shqiptohet një dënim më i rëndë, siç pretendon pala e dëmtuar, aq më parë kur në ankesë nuk theksohen rrethana të tilla që do të justifikonin një dënim më të ashpër.

Për këto arsye u deshtë që ankesa përkitazi me vendimin mbi dënimin të refuzohet si e pabazuara.

Nga çka u tha si me lartë konform nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr. 407/2017 i datës 22.09. 2017

Procesmbajtësi:

Bujar Bala

Anëtarët e kolegjit:

Tonka Berishaj_____

Mejreme Memaj_____

Kryetari i kolegjit:

Xhevdet Abazi